



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## Raporti vjetor i punës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2025

### **Investime kapitale:**

-Ka përfunduar ndërtimi i anex-it të administratës dhe renovimi i hapsirave të teatrit Avdush Hasani

- Ka përfunduar ndërtimi i Memorialit dhe Shtatorja Afrim Zhitia në Lluga.

- Ka përfunduar ndërtimi i tereneve dhe hapsirave sportive në vlerë 425.000 euro projekt dy vjeçar dhe janë në vijim:

1. Ndërtimi i fushes në fshatin Peran
2. Rrethoja dhe ndriqimi i terrenit sportiv në lagjen e Polonicëve
3. Ndriqimi i terrenit sportiv në fshatin Gllamnik
4. Rrethoja dhe ndriqimi i terrenit sportiv në fshatin Lupq
5. Ndërtimi i terrenit sportiv në fshatin Sibovc
6. Rrethoja dhe ndriqimi i terrenit sportiv në fshatin Sfeqël
7. Rrethoja dhe ndriqimi i terrenit sportiv në fshatin Surkish
8. Rrethoja dhe ndriqimi i terrenit sportiv në lagjen e Breçalivë
9. Ndërtimi, rrethoja dhe ndriqimi i terrenit sportiv mbrapa postës
10. Montimi i barit sintetik dhe ndriqimi i terrenit sportiv në fshatin Pollatë
11. Ndërtimi i terrenit sportiv me bari sintetik në fshatin Bellopojë
12. Ndërtimi, rrethoja dhe ndriqimi i fushes së Tenisit në parkun e Manqesterit
13. Punimi i hapsirave në dy etazhe në objektin e palestrës për sportet Marciale-Mikse
14. Ndërtimi dhe rrethoja e terrenit sportiv në fshatin Gërdoc

15. Ndërtimi dhe rrethoja e terrenit sportiv në fshatin Sekirraqë
16. Ndërtimi dhe rrethojat e terrenit sportiv me bari sintetik në fshatin Kaqybeg
17. Ndërtimi i terrenit sportiv me bari sintetik në fshatin Obranqë
18. Ndërtimi i terrenit të Voljebollit në Rërë te parku i Manqesterit
19. Rrethoja e terrenit në fshatin Dumnicë e Poshtme
20. Rregullimi i shtigjeve për ecje në parkun e qytetit te pishat

- Ndërtimi i Qendrës Multifunkcionale është në fazën përfundimtare, pritet të funksionalizohet në fillim vitit 2026.

- Ka fillu ndërtimi i Pishinës Gjysëmolimpike

- Ka filluar nërtimi i fushës për Tennis

#### **Subvencione:**

- Bazuar në thirrjet publike për financim të OJQ-ve në Kulturë, Rini dhe Sport, përmes vendimeve të kryetarit, DKRS ka subvencionuar për vitin 2025 përafërsisht 120.000 euro, klubet, shoqatat sportive, OJQ-të kulturore dhe rinore

#### **Kultura:**

*Galeria e Arteve* - 10 Ekspozita gjat vitit 2025.

*Manifestime* - 10 manifestime të ndryshme kulturore dhe përkujtimore

*Ditët e Diasporës* - për dy javë ka pasur aktivitete të ndryshme kulturore dhe sportive në sheshin e qytetit, si koncerte, panairë, turne etj.

*Koncerte* - 11 me këngëtar te estradës dhe këngëtar lokal

*Panairë* – 4. Panairi i librit dhe 3 panairë me produkte artizanale.

*Teatri* – Dy premjera të realizuara për vtin 2025, ndersa 26 repriza të shfaqjeve për të rritur dhe për fëmijë.

Trupa e teatrit “Avdush Hasani” gjatë vitit 2025 mori pjesë në festivale teatrore brenda dhe jashtë vendit.

**Biblioteka:** *Libra të rinj* - Me 536 tituj të rinj është pasuruar biblioteka e qytetit, në gjithsej 2894 ekzemplar. Kurse në bibliotek janë regjistruar gjithsej 465 lexues në dy sektorët. Në të dy sektorët janë ndërruar 6231 libra. Sallën e leximit e kanë shfrytëzuar 4020 studentë, ndërsa këndin e fëmijëve e shfrytëzuan për lexim gjithsej 1232 nxëns.

*Aktivitetet e realizuara* – Ekspozita e librit prill 2025 gjatë muajt prill, vizita të ndryshme sistematike të shkollave fillore dhe të mesme pothuajse nga të gjitha shkollat që gravitojnë në komunën tonë. Po ashtu në kuadër të Ditës Ndërlombëtare të Librit Biblioteka e Qytetit ka mbajtur një program të larmishëm si dhe ka shpërblyer lexuesit e dalluar të Bibliotekës.

Në kuadër të aktiviteteve kulturore, bibliotek organizoi një dramë festive me rastin e Ditës së fëmijëve, duke promovuar trashëgiminë kombëtare dhe duke përfshirë edhe nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme.

#### **Arkivi:**

Janë ripunuar 45 kuti të materialit arkivor të ish firmave private të fondit arkivor. Janë dhënë në shfrytëzim në vazhdimësi vendimet e këti sektori palëve të interesuara (ish pronarëve të firmave private), janë dhënë në shfrytëzim qindara kopje dokumentash të cilat janë në shërbim të publikut, individve dhe subjekteve juridike të ndryshme. Janë sistemuar ditarët e dy shkollave të mesme të ulta Shkolla “Ali Ajeti” Sfeqël dhe Shkolla “Jetullah Gashi” Dobërdol

Janë përpunuar 37m. gjatësi material i papërpunuar

#### **Rinia:**

*Aktivitetet Rinore* - Përpos subvencionimit të OJQ-ve me subvencione në projekte për të rinjtë, gjithashtu janë organizuar gjithësej 5 aktivitete që kanë synuar gjithëpërfshirjen e të rinjve, të cilat kanë pas kryesisht karakter edukues në fusha të ndryshme.

## **Sporti:**

*Organizime Sportive* - gjithsej 43 organizime sportive , si turne në Futboll, gara në Basketboll, Volejball, Atletikë, Triathlon, Festivali i Kajakimit, Tenis, Ping Pong, Shah, Not, Ciklizëm, Bjeshkatari, Arte të Miksuara Marciale, Karate, Xhudo, Cick Boks dhe të tjera me theks përfshirjen e vajzave në sport dhe përgjithësisht të rinjtë.

*Grupe të marginalizuara* - Janë përkrahur projekte dhe organizuar aktivitete në mbështetje të komunitetit ashkali në kulturë dhe sport

*Persona me aftësi të kufizuar* - jan subvencionuar projekte sportive dhe edukative për personat e verbër.

Podujevë 19.12.2025

per  
Drejoria për Kulturë, Rini dhe Sport

